



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

SHKOLLA 9-VJEÇARE "ANDON XOXA" FIER

Nr. 196 Prot.

Fier, më 23.08 2026

LËNDA: NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimit nr.22 datë 13.11.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar", shkolla 9-vjeçare "Andon Xoxa", Fier shpall 1(një) vend të lirë pune për pozicionin e nëndrejtorit.

1)Kandidatët për nëndrejtor të insitucionit publik të arsimit

parauniversitar duhet:

- a) të zotërojë arsimim si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit nr 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar", me vlerësim jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit;
- c) të mos ketë masa disiplinore ne fuqi ndaj tij ;
- d) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar

2)Dokumentet që do të paraqesë aplikanti janë:

- a) jetëshkrim (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi)
- b) kopjen e librezës së punës
- c) kopjo të dokumentit të identitetit (ID)
- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 5 të udhëzimit)

e) certifikatën e drejtuesit të IPAP-së

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi)

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

h) deklaratën për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 8, të këtij udhëzimi

i) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP-së (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3) Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në IPAP ose në rrugë elektronike shkollaandonxoxa@gmail.com

“Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për nëndrejtor të insitucionit publik të arsimit parauniversitar në faqen elektronike zyrtare të ZVAP”

Duke ju falenderuar,

DREJTOR

ANILA PIPERI

